



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSEDNIK

**DEKRET PËR RATIFIKIM TË MARRËVESHJES
NDËRKOMBËTARE**

Duke u bazuar në nenin 18, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe në nenin 4, pika 3 të Ligjit Nr.03/L-004 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik:

D e k r e t o j

Ratifikimin e Marrëveshjes Mbi Transportin ndërkombëtar Rrugor të udhëtareve dhe mallrave, në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, e nënshkruar në Prishtinë me datë 24 gusht 2011, dhe të pranuar në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës me datë 03 tetor 2011.

Marrëveshja e ratifikuar i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për njoftim, në përputhje me nenin 18, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Marrëveshja e ratifikuar hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare.

Nr. i Dekretit: DMN-028-2011

Prishtinë, më 07 tetor 2011



Atifete Jahjaga

Presidente e Republikës së Kosovës

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kroacisë (në tekstin e mëtejshëm: palët kontraktuese);

Me dëshirë që ta avancojnë zhvillimin e tregtisë dhe të marrëdhënieve ekonomike ndërmjet dy shteteve;

Të vendosura që të promovojnë bashkëpunimin në transportin ndërkombëtar në suaza të ekonomisë së tregut;

Të interesuara për mbrojtjen e mjedisit dhe të njerëzve, për shfrytëzimin racional të energjisë, për shtimin e sigurisë në komunikacionin rrugor dhe për përmirësimin e kushteve të punës së shoferëve;

Me qëllim të zhvillimit të intermodaliteteve të transportit;

Duke pasur parasysh interesin dhe dobinë e përbashkët nga marrëveshja për transportin rrugor ndërkombëtar;

Janë pajtuar për sa vijon:

I. DISPOZITAT E PËRGITHSHME

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Me këtë marrëveshje rregullohet transporti rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve dhe mallrave, që e bëjnë transportuesit të cilët e kanë selinë e veprimtarisë në territorin shtetëror të njëjës nga palët kontraktuese, me automjete të regjistruara në atë territor shtetëror, që e ka vendnisjen në territorin e njëjës palë kontraktuese, kurse vendarritjen në territorin e palës tjetër, apo transit, nëpër territorin shtetëror të njëjës nga palët kontraktuese.
2. Kjo kontratë nuk ndikon në të drejtat dhe detyrimet që dalin nga marrëveshjet tjera ndërkombëtare, të cilat i obligojnë palët kontraktuese.

Neni 2.

Definicionet

Sipas kësaj Marrëveshjeje, definicionet në vijim kanë këtë domethënie:

1. "Transportues"- çdo person fizik apo juridik që është i autorizuar të bëjë transportimin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave, në pajtim me normat juridike të palës kontraktuese në territorin shtetëror të së cilës e ka selinë e veprimtarisë.
2. "Automjet" - automjet me motor apo një tërësi automjetesh, të regjistruara në territorin shtetëror të njëjës nga palët kontraktuese që për nga konstruksioni dhe pajisjet e tij është i paraparë për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe të mallrave, e që është në dispozicion të transportuesit, qoftë si pronë e tij, apo i huazuar, ose i marrë me qira sipas kontratës.
3. "Transport" - qarkullimi me automjet, me apo pa udhëtarë, duke përfshirë edhe mbartjen e automjetit me tren apo anije përgjatë një segmenti rrugor,
4. "Kabotazhi" - mbartja e udhëtarëve apo e mallrave ndërmjet disa pikave në territorin shtetëror të njëjës prej palëve kontraktuese, që e bën transportuesi i palës tjetër kontraktuese.
5. "Transport i kombinuar" - transporti i mallrave me kamion, rimorkio, gjysmërimorkio, me ndonjë mjet tjetër zëvendësues apo kontejner, me apo pa automjet për tërheqje, që qarkullojnë vetëm në segmentin fillestar apo përfundimtar të rrugës, i cili duhet të jetë sa më i shkurtër, ndërsa në segmentin kryesor të rrugës transportohen me tren, rrugës së brendshme lumore apo detare.

6. "Territoret e palëve kontraktuese" - territori shtetëror i Republikës së Kosovës dhe territori shtetëror i Republikës së Kroacisë.
7. "Shteti i themelimit" - shteti i palës kontraktuese në të cilin transportuesi e ka selinë e veprimtarisë dhe në të cilin është regjistruar automjeti.
8. "Shtet nikoqir" - shteti i palës kontraktuese, ku transportuesi e ushtron veprimtarinë, në të cilin nuk është i regjistruar automjeti dhe nuk e ka selinë e veprimtarisë.
9. "Linjë e transportimit të udhëtarëve" - linjë në të cilën mbarten udhëtarët me itinerar të caktuar dhe sipas orarit të udhëtimeve dhe listës së çmimeve, paraprakisht të përcaktuara dhe të publikuara, me ç' rast udhëtarët hyjnë dhe zbresin në vendndalime të caktuara më përpara.
10. "Transport i njëpasnjëshëm" - është transporti i grupeve të formuara më parë për më shumë udhëtime nga i njëjti vend i nisjes në të njëjtin vend të arritjes. Vend i nisjes, përkatësisht vend i arritjes janë vendet ku fillon udhëtimi, përkatësisht ku përfundon, duke përfshirë edhe vendet përreth, brenda radiusit prej 50 km. Secili grup i përbërë prej udhëtarëve, që ka arritur në vendin e paraparë, më pas kthehet me automjet në vendin e nisjes. Fakti se disa udhëtarë kthehen me grupin tjetër, nuk ndikon në kualifikimin e transportit si transport i njëpasnjëshëm. Udhëtimi i parë kthyes dhe udhëtimi i fundit për ta marrë grupin e dërguar, në vargun e udhëtimeve të njëpasnjëshme, bëhet me automjet të zbrazët.
11. "Transport i kohëpaskohshëm" - shënon transportin, i cili nuk përfshihet me definicionin e linjës transportuese të udhëtarëve, e as me definicionin e transportit të njëpasnjëshëm, me ç' rast shpeshësia apo numri i udhëtimeve nuk ndikojnë në atë që ato të kualifikohen si transport i kohëpaskohshëm.
12. "Dokument kontrolli" - është fletudhëtimi për autobusë, që është në përputhje me formularin e përcaktuar nga Komisioni i përbashkët nga neni 13. i kësaj Marrëveshjeje.

II. TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3.

Linja e transportit të udhëtarëve

1. Transporti përmes linjave të udhëtarëve përcaktohet me regjim të lejeve, të cilat i jep organi kompetent në shtetin e vendnisjes, vendarritjes dhe transit.
2. Kërkesa për leje nga paragrafi 1. i këtij neni i paraqitet organin kompetent në shtetin ku transportuesi e ka selinë e veprimtarisë. Në qoftë se organi kompetent shtetëror, ku është selia e veprimtarisë, e miraton kërkesën, kërkesa i dërgohet organit kompetent shtetëror të palës tjetër kontraktuese.

Komisioni i përbashkët, i formuar në pajtim me nenin 13. të kësaj kontrate, vendos për mënyrën e paraqitjes së kërkesës për leje dhe për dokumentet që duhet bashkëngjitur, për kushtet ekologjike, të sigurisë dhe të tjera për dhënien e lejes.

3. Leja jepet në bazë të marrëveshjes së arritur nga organet kompetente të palëve kontraktuese.

Vendimin për dhënien apo refuzimin e dhënies së lejes, organet kompetente të palëve kontraktuese e marrin në afat prej 90 ditësh nga dita e marrjes së kërkesës për leje nga organi kompetent i shtetit ku gjendet selia e veprimtarisë, nëse nuk ndodhë të krijohen rrethana të paparashikuara.

Në rast rrethanash të paparashikuara, ky afat mund të ndryshohet dhe për këtë organet kompetente do ta njoftojnë njëra-tjetrën.

~~... nga paragrafi 1. i këtij neni vlen me së shumti pesë vjet. Me leje përcaktohen kushtet operative për transportin e udhëtarëve në linja të caktuara.~~

4. Për ndryshimin e kushteve operative dhe për ndërprerjen e transportit vendoset sipas procedurës së përcaktuar me paragrafin 2. dhe 3. të këtij neni.

Në qoftë se s'ka më kërkesa për transport, transportuesi mund ta ndërpresë atë, për çka do t' i njoftojë organet kompetente që i kanë dhënë lejet, si dhe shfrytëzuesit, brenda afatit të cilin e përcakton Komisioni i përbashkët nga neni 13. i kësaj marrëveshjeje.

Neni 4.

Transporti i herëpashershëm dhe i njëpasnjëshëm

1. Për transportin e herëpashershëm dhe të njëpasnjëshëm të udhëtarëve nevojitet leja.
2. Bëjnë përjashtim nga paragrafi 1. i këtij neni transportet e cekura në vijim, për të cilat nuk nevojitet leja në territorin shtetëror të palëve kontraktuese:
 - 2.1 transportet qarkore me dyer të mbyllura, duke shfrytëzuar të njëjtin autobus për mbartjen e të njëjtit grup të udhëtarëve përgjatë gjithë udhëtimit dhe për kthimin e tyre në vendin e nisjes, në shtetin e selisë së veprimtarisë së transportuesit;
 - 2.2 transportet, në të cilat udhëtarët mbarten nga vendi i nisjes në territorin shtetëror të shtetit të selisë së veprimtarisë së transportuesit deri në vendin e paraparë, kurse gjatë kthimit automjeti është i zbrazët;
 - 2.3 udhëtimet kur shkohet me automjet të zbrazët, kurse në të kthyer, me udhëtarë, me kusht që udhëtarët:
 - a) të përbëjnë grup të formuar në pajtim me kontratën për transport, të lidhur para ardhjes së tyre në territorin shtetëror të shtetit nikoqir, prej nga ata merren përsëri dhe transportohen në territorin shtetëror të shtetit të selisë së veprimtarisë;
 - b) t'i ketë çuar më parë i njëjti transportues në territorin shtetëror të palës kontraktuese, ku ata merren përsëri dhe kthehen në territorin shtetëror të shtetit të selisë së veprimtarisë;
 - c) të jenë të ftuar në territorin shtetëror të shtetit ku e ka selinë e veprimtarisë transportuesi, me ç rast shpenzimet e transportit i bartë personi që i ka ftuar.
3. Marrja dhe zbritja e udhëtarëve gjatë udhëtimit nga paragrafi 2. i këtij neni, nuk është e lejuar pa pasur leje të veçantë, të lëshuar nga organi kompetent i shtetit nikoqir.
4. Kërkesa për dhënie të lejes nga paragrafi 1. i këtij neni i paraqitet organit kompetent të shtetit ku transportuesi e ka selinë e veprimtarisë.
5. Komisioni i përbashkët, i formuar në pajtim me nenin 13. të kësaj Marrëveshjeje, e përcakton formularin e kërkesës për dhënie të lejes, si dhe dokumentet tjera që duhet bashkëngjitur.

Leja jepet apo refuzohet në afat prej 30 ditësh, përveç rasteve kur krijohen rrethana të paparashikuara.

Në rast të krijimit të rrethanave të paparashikuara, ky afat mund të ndryshojë dhe për këtë organet kompetente do ta njoftojnë njëra-tjetrën.
6. Gjatë transportit të udhëtarëve, transportuesi është i obliguar që ta ketë në automjet dokumentin e kontrollit.

Dispozitat e përbashkëta për transportin e udhëtarëve

1. Lejet për transport nga pika 3. dhe 4. e kësaj Marrëveshjeje janë personale dhe nuk mund të barten tek transportuesit tjerë.
2. Kryerja e shërbimeve të kabotazhit është e ndaluar. Udhëtimet lokale, që organizohen vetëm për grupet e udhëtarëve që i ka sjellë në atë lokalitet i njëjti transportues, nuk konsiderohen kabotazh, me kusht që të jenë të evidentuar në dokumentin e kontrollit.

III. TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 6.

Regjimi i lejeve

1. Transportuesit mund të transportojnë mallra ndërmjet territoreve shtetërore të të dy palëve kontraktuese, gjithashtu dhe transit, përmes palëve kontraktuese pa leje.
2. Transportuesit mund të transportojnë mallra ndërmjet territoreve shtetërore të vendit nikoqir dhe vendeve të treta vetëm atëherë kur paraprakisht janë pajisur me leje të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit nikoqir.
3. Lejet përdoren vetëm në emër të transportuesit të cilit iu kanë lëshuar ato dhe nuk janë të transferueshme. Lejet duhet të mbahen në automjet gjatë gjithë udhëtimit dhe duhet të tregohen me kërkesë të çdo oficeri të kontrollit të autorizuar.
4. Organet kompetente të palëve kontraktuese bëjnë shkëmbimin e një numri të caktuar të lejeve për transport të mallrave, të pajtuar nga komisioni i përbashkët, bazuar në neni 13. Komisioni i përbashkët ka të drejt të përjashtojë nga regjimi i lejeve lloje të caktuara të transportit deri te liberalizmi i plotë.
5. Kabotazhi është i lejuar vetëm me leje të veçantë të organit kompetent të shtetit nikoqir.

Neni 7.

Përjashtimet nga regjimi i lejeve

1. Bëjnë përjashtim nga dispozitat e nenit 6. të kësaj Marrëveshjeje dhe mund të kryhen pa pasur leje, këto lloje të transportit:
 - a) transporti me automjete, masa e përgjithshme e lejuar e të cilave, me gjithë rimorkio, nuk i tejkalon 6 tonë, apo kur masa e shfrytëzueshme e lejuar, së bashku me rimorkio, nuk i tejkalon 3,5 tonë;
 - b) transporti i herëpashershëm deri apo nga aeroportet në rast të ndryshimit të kursit të fluturimeve të rregullta;
 - c) transporti i automjeteve të dëmtuara, apo në gjendje jo të rregullt dhe të automjeteve që duhet të riparohen;
 - d) udhëtimet me automjete të zbrazëta, të dërguara për ta zëvendësuar automjetin që është prishur brenda territorit shtetëror të njërit nga palët kontraktuese, si dhe udhëtimi për t' u kthyer, pas riparimit të automjetit të prishur;
 - e) transporti i kafshëve në automjete posaçërisht të konstruara, apo të parapara për transportin e përhershëm të kafshëve, që janë pranuar si të tilla nga ana e organeve kompetente të shtetit të selisë së veprimtarisë;
 - f) transporti i pjesëve rezervë dhe gjërave të nevojshme për aeroplanë dhe anije tejoqeanike;

~~... dhe pajisjeve mjekësore të nevojshme për raste të jashtëzakonshme~~
posaçërisht në raste të fatkeqësive natyrore dhe për nevoja humanitare;

- h) transporti i veprave dhe objekteve artistike për panaire dhe ekspozita, apo për qëllime jokomerciale;
 - i) transporti, për qëllime jokomerciale, i pajisjeve dhe kafshëve për shfaqje teatrore, muzikore, filmi, sportive, apo cirqe, për panaire apo festivale, si dhe të pajisjeve urgjentisht të nevojshme për incizime për radio, për xhirim të filmave apo të emisioneve televizive;
 - j) transporte funerali.
2. Gjatë kryerjes së transportit nga ky nen, shoferi duhet t'i ketë të gjitha dokumentet, të cilat dëshmojnë qartë se bëhet fjalë për njërin nga llojet e transportit të mësipërm.
 3. Komisioni i përbashkët nga neni 13. i kësaj Marrëveshjeje mund ta zgjerojë listën e llojeve të transportit nga paragrafi 1. i këtij neni, për të cilat nuk nevojitet leje.

IV. DISPOZITAT E PËRBASHKËTA

Neni 8.

Pagesat

1. Transporti me automjete të regjistruara në territorin shtetëror të njëjës palë kontraktuese, që përkohësisht gjenden në territorin shtetëror të palës tjetër kontraktuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, është i liruar, sipas parimeve të reciprocitetit, nga pagesa e të gjitha tatimeve dhe taksave që kanë të bëjnë me pronësinë, regjistrimin dhe qarkullimin e automjeteve.
2. Lënda djegëse, e cila gjendet në rezervuare standarde të automjeteve të montuara nga prodhuesi, të parapara për qarkullimin e automjetit dhe funksionimin e automjetit motorik në temperaturë të kontrolluar, lyrësuesit, si dhe pjesët rezervë, janë të lira nga taksat doganore e importit në territorin shtetëror të shtetit nikoqir.
3. Transporti i përfshirë me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është i liruar nga pagesa e kompensimeve për shfrytëzimin e rrugëve.
4. Transporti i përfshirë me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohet pagesës së taksës rrugore dhe taksave tjera që paguhen për shfrytëzimin e rrugëve, urave, tuneleve, etj. në shtetin nikoqir. Taksa rrugore paguajnë transportuesit vendës dhe të huaj, pa diskriminim.

Neni 9.

Masa dhe dimensionet e automjetit

1. Masa maksimale e lejuar, pesha mbi bosht dhe dimensionet e automjeteve, nuk lejohet të tejkalojnë vlerat e cekura në dokumentet e regjistrimit e as vlerat maksimale të lejuara që aplikohen në shtetin nikoqir.
2. Shfrytëzimi i automjeteve në shtetin nikoqir, masa dhe dimensionet e të cilave i tejkalojnë kufijtë maksimalë, lejohet vetëm me leje të veçantë, që e jep organi kompetent i shtetit nikoqir, nëse kërkesa për marrjen e saj është paraqitur më përpara.

Pajisjet dhe karakteristikat tjera të automjetit

1. Automjetet, të cilat transportojnë lëndë të rrezikshme, apo artikuj që prishen lehtë, duhet të jenë të pajisura në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes evropiane mbi transportin rrugor ndërkombëtar të lëndëve të rrezikshme, të datës 30 shtator 1957, siç është ndryshuar (ADR) dhe kërkesat e Marrëveshjes mbi transportin ndërkombëtar të artikujve që prishen lehtë në automjete speciale për transportin e tyre (ATP), të dt. 1 shtator 1970.
2. Pajisja, e cila përdoret për matjen e kohës së udhëtimit dhe të pushimit të ekuipazhit në automjete, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes evropiane mbi punën e ekuipazhit në automjetet që kryejnë shërbime të transportit rrugor ndërkombëtar, të dt. 1 korrik 1970, siç është ndryshuar (AETR).

Neni 11. Mbikëqyrja

Lejet dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara më këtë Marrëveshje dhe me marrëveshje shumëpalëshe, të cilat i obligojnë palët kontraktuese, apo ato të parapara me legjislacionin nacional (listat e mallrave, fletudhëtimet, certifikatat e sigurimeve, dëftesat mbi aftësimin profesional, etj.) duhet të mbahen në automjet dhe të tregohen kur këtë e kërkojnë organet kompetente të palëve kontraktuese.

Neni 12. Obligimet e transportuesit dhe kundërvajtjet

1. Transportuesit e palës kontraktuese, gjatë qëndrimit në territorin shtetëror të palës tjetër kontraktuese, janë të obliguar t' i respektojnë detyrimet që dalin nga kontratat shumëpalëshe ndërkombëtare, të cilat i obligojnë palët kontraktuese, ato nga marrëveshjet tjera dypalëshe, si dhe ato nga legjislacioni nacional, veçmas ato që kanë të bëjnë me qarkullimin dhe kundërvajtjen, me dispozitat doganore dhe me kushtet e kufizimet tjera, të përcaktuara në leje.
2. Në rast të çfarëdo shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga transportuesi, organi kompetent i shtetit nikoqir e informon për këtë organin kompetent të shtetit të selisë së veprimtarisë, me qëllim që ai organ të marrë masa të nevojshme kundër transportuesit, siç është paraparë me legjislacionin e tij nacional.
3. Dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni nuk i përjashtojnë masat që i marrin organet gjyqësore, apo organet tjera kompetente të shtetit nikoqir.
4. Në rast të përsëritjes së kundërvajtjeve të rënda, të bëra në territorin shtetëror të shtetit nikoqir, organi kompetent i shtetit nikoqir mund t' i marrë vetë, apo me kërkesë të organit kompetent të shtetit të selisë së veprimtarisë, këto masa:
 - a) t'i japë vërejtje transportuesit;
 - b) t'ia ndalojë hyrjen në territorin shtetëror të palës kontraktuese ku është bërë kundërvajtja.
5. Palët kontraktuese e njoftojnë njëra-tjetrën për sanksionet e shqiptuara në përputhje me paragrafin 4. të këtij neni.

Neni 13. Bashkëpunimi dhe Komisioni i përbashkët

1. Palët kontraktuese i marrin të gjitha masat e nevojshme për aplikimin e kësaj Marrëveshjeje dhe e njoftojnë njëra-tjetrën me të gjitha informatat e dobishme dhe me të gjitha ndryshimet në legjislacionin nacional në lëmin e transportit rrugor, të cilat ndikojnë në aplikimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Palët kontraktuese e formojnë Komisionin e përbashkët për nevoja të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe për shqyrtimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me raportet ndërmjet palëve kontraktuese në lëmin e transportit rrugor, duke përfshirë edhe aspektet që lidhen me sigurinë, me mbrojtjen e ambientit, me ekuipazhet e automjeteve, me çështjet teknike, me promovimin e ndërmarrjeve të qarkullimit rrugor, me çështjet e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe të zgjidhjes së kontesteve .

V. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14.

Organet kompetente

1. Organet kompetente për zbatimin kësaj Marrëveshjeje janë:
 - Në Republikën e Kosovës: Ministria e Infrastrukturës.
 - Në Republikën e Kroacisë: Ministria e Detarisë, Transportit dhe Infrastrukturës;
2. Palët kontraktuese do të informojnë njëra tjetrën mbi ndryshimet në lidhje me autoritetin kompetent.

Neni 15.

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e marrjes së informatës së fundit me shkrim, me të cilën palët kontraktuese e njoftojnë njëra-tjetrën, me rrugë diplomatike, se i kanë përfunduar procedurat e tyre juridike për hyrjen e saj në fuqi.
2. Kjo Marrëveshje lidhet për kohë të pacaktuar. Secila nga palët kontraktuese mund ta shkëpusë këtë Marrëveshje, për çka do ta njoftojë me shkrim palën tjetër kontraktuese, me rrugë diplomatike. Me atë rast vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje merr fund gjashtë (6) muaj pas datës kur pala tjetër kontraktuese e ka marrë njoftimin për shkëputjen e saj.

E përpiluar në Prishtinë, më dt. 24/08/2011, në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhën shqipe, kroate dhe angleze, që të gjithë janë njësoj autentikë. Në rast të çfarëdo dallimi në interpretim, do të vlejë teksti në gjuhën angleze.

Për Qeverinë e
Republikës së Kosovës



Për Qeverinë e
Republikës së Kroacisë

